

Letër e interesit për përfundimin e autostradës Prishtinë-Beograd

Duke rikonfirmuar përkushtimin e Republikës së Kosovës për të kontribuar plotësisht në konsolidimin ekonomik, përshejtim të qarkullimit të mallrave, njerëzve dhe shërbimit dhe lidhjes më të afërt të Ballkanit Perëndimor dhe të gjithë qytetarëve që jetojnë në rajon, Ministria e Infrastrukturës dhe Transportit në Kosovë dëshiron të njoftojë dhe të konfirmojë deklaratën në vazhdim në lidhje me ndërtimit dhe kompletimit e autostradës Prishtinë-Beograd.

Autostrada do të lidh Prishtinën dhe Beogradin përmes pikës së kalimit kufitar në Merdare dhe pastaj përmes Nishit nëpërmes ndërtimit të rrugës së re.

Ndërtimi i infrastrukturës së autostradës që e lidh Prishtinën me Beogradin ka rëndësi strategjike për ekonominë e Kosovës, duke pasur parasysh që një përqindje e madhe e pasagjerëve dhe mallrave në tregjet rajonale transportohen në mënyrë rrugore dhe pasi është njëra nga dy lidhjet kryesore në rrjetin e transportit rajonal dhe kryeqytetet fqinje.

Autostrada do të shërbejë si një komponent kyq në rrjetin kryesor të Europës në transportin regjional, duke i lidhur korridoret rrugore Pan-Europiane me portet në bregdetin e Adriatikut.

Me qëllimin e vendosjes së transportit të pasagjerëve dhe mallrave përmes autostradës së propozuar, infrastruktura përkatëse duhet të ndërtohet dhe duhet të përcillet me zbatim të marrëveshjeve teknike, ligjore dhe profesionale për vendosjen e transportit rrugor.

Specifikacionet teknike për autostradën duhet gjithashtu të jenë në linjë me Standardet Rrugore Trans-Europiane (TEM)

Duke implementuar këtë iniciativë, provizionet që përbëjnë strukturën ekzistuese ndërkombëtare, do të zbatohen, gjithashtu edhe ato të përcaktuara në marrëveshjet dhe rregullimet të vendosura brenda Bashkimit Europian.